

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju informojmë se:

Ka transmetuar reklama politike brenda edicionit të lajmeve OSHMA:

TV Klan News 15:15, 15:18, 15:20, 15:22, 15:29, 15:37, 16:24, 16:25, 16:26, 16:28, 16:49, 16:50, 17:06, 17:09, 17:18, 17:24, 17:30, 17:39, 21:34, 21:35, 21:37, 21:38, 21:40, 21:41, 22:06, 22:07, 22:08, 22:09, 22:13, 22:17, 22:32 dhe 22:36

Kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

TV News 24 20:49

Shijak TV 18:33, 19:58 dhe 20:33.

TV 6+1 09:42, 09:45, 09:46, 09:47, 09:48, 09:50, 09:51, 09:52, 11:01, 11:02, 11:03, 11:05, 11:06, 11:07, 11:08, 13:45, 13:46, 13:47, 13:49, 13:50, 13:51, 13:52, 14:18, 14:19, 14:20, 14:22, 14:23 dhe 14:24

Best TV 08:23, 08:36, 09:45, 10:22, 10:35, 12:19, 13:56, 18:14, 19:35 dhe 20:00

One TV Vlora 08:27, 09:47, 10:54, 11:37, 12:47, 13:22, 14:54, 18:19, 18:57 dhe 20:00

Ka transmetuar reklama politike të paightifikuara OSHMA:

TV 6+1 09:47 dhe 23:15

TV Channel 7; One TV Vlora; TV Glob dhe TV Kukësi nuk depozituan në AMA më datë 12.04.2021 regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të një dite më parë.

AMA rikujton këto subjekte, por dhe të tjera, të njoftuara nga AMA në mënyrë të përsëritur, me shkresë zyrtare dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta, se duhet që të zbatojnë sistematikisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ. Përmbajtjet e regjistruara duhet të depozitohen në AMA brenda orës 10:00 të ditës së nesërme të transmetimit.

TV Bulqiza, në mënyrë të përsëritur, ka transmetuar dhe më datë 11.04.2021, ora 15.00, edicionin informativ të një OSHMA-je tjetër. Subjekti ka marrë njoftime nga AMA që ta ndërpresë një praktikë të tillë.

Pas kërkesës së fundmi që ka bërë në AMA TV Euronews Albania, për rillogaritje të kohës elektorale në emisionet e transmetuara më datë 01.04.2021, nga verifikimi i përmbajtjeve të transmetuara dhe ritransmetuara atë ditë, rezultoi se, subjektit politik PS i takonin 33.8 minuta. Kjo kohë do të reflektohet në tabelën përmbledhëse mujore të kësaj OSHMA-je, duke evituar gabimin njerëzor gjatë procesit të vlerësimit në monitorim.

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet nga monitorimi për transmetimet e datës 11.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 12.04.2021